# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**
**www.qpz.gov.al**

**Nr.136 18 shtator 2009**


P Ë R M B A J T J A


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Vendim i KM nr.858, datë 5.8.2009 | Për hapjen e programeve të reja të studimit, pranë shkollës së lartë universitare private“Zoja e Këshillit të Mirë” ..... | 6295 |
| Vendim i KM nr.867, datë 12.8.2009 | Për disa shtesa në vendimin nr.335, datë 2.9.1997 të Këshillit të Ministrave “Për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit”, të ndryshuar ..... | 6296 |
| Vendim i KM nr.870, datë 12.8.2009 | Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Prezë të qarkut të Tiranës ..... | 6296 |
| Vendim i KM nr.871, datë 12.8.2009 | Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Qendër Fier, të qarkut të Fierit ..... | 6297 |
| Vendim i KM nr.872, datë 12.8.2009 | Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Çorovodë, të qarkut të Beratit ..... | 6298 |
| Vendim i KM nr.874, datë 12.8.2009 | Për organizimin dhe funksionimin e bordit të mbikëqyrjes publike të ekspertëve kontabël, të regjistruar ..... | 6299 |
| Vendim i KM nr.879, datë 12.8.2009 | Për dhënien e licencës për hapjen e institucionit arsimor privat, parauniversitar, gjimnazi “Linz”, në qytetin e Tiranës ..... | 6303 |
| Vendim i KM nr.880, datë 12.8.2009 | Për hapjen e programeve të studimeve “Master i nivelit të parë”, në Universitetin Bujqësor të Tiranës ..... | 6303 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i KM nr.881, datë 12.8.2009 | Për hapjen e programeve të studimit, “Master i nivelit të parë”, në Universitetin e Tiranës ..... | 6304 |
| Vendim i KM nr.882, datë 12.8.2009 | Për heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor të disa sipërfaqeve, përkatësisht, në ngastrat e ekonomive pyjore të qarkut Shkodër e Lezhë, që do të përdoren nga OST, sh.a. për ndërtimin e linjës 400 kv Podgoricë-Tiranë ..... | 6305 |

**VENDIM**
**Nr.858, datë 5.8.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT, PRANË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE "ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, pranë shkollës së lartë universitare, private "Zoja e Këshillit të Mirë" të programit të studimit "Master i nivelit të parë", për "Menaxhim për funksionet e koordinimit".

2. Programi i studimit "Master i nivelit të parë" do të jetë program studimi i ciklit të dytë, në plotësimin e, të paktën, 60 krediteve. Në mbarim të tij lëshohet diplomë "Master i nivelit të parë" (MNP), në "Menaxhim për funksionet e koordinimit".

3. Hapjen, pranë shkollës së lartë universitare, private "Zoja e Këshillit të Mirë", të programeve të studimit "Master i nivelit të dytë", në:

a) Qeverisje dhe zhvillim territorial;

b) Organizim e drejtim i institucioneve dhe i shërbimeve shëndetësore;

c) Ortodonci;

ç) Implantologji dhe proteza dentare.

4. Programi i studimit "Master i nivelit të dytë" do të jetë program studimi të ciklit të tretë, në plotësimin e, të paktën, 60 krediteve. Në mbarim të tyre lëshohet diplomë "Master i nivelit të dytë" (MND), përkatësisht, në:

a) "Qeverisje dhe zhvillim territorial";

b) "Organizim e drejtim i institucioneve dhe i shërbimeve shëndetësore";

c) "Ortodonci"

ç) "Implantologji dhe proteza dentare".

5. Ngarkohet shkolla e lartë universitare, private "Zoja e Këshillit të Mirë", që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

6. Shkolla e lartë universitare, private "Zoja e Këshillit të Mirë" do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikat 1 e 3 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse, nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

7. Ndryshimet në vendndodhje, forma studimi, plane dhe programe, si dhe elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

8. Shkolla e lartë universitare, private, "Zoja e Këshillit të Mirë" duhet t'i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

9. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.867, datë 12.8.2009**

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.335, DATË 2.9.1997 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR LËSHIMIN E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8668, datë 23.11.2000 "Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.335, datë 2.9.1997 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 3 shtohet emërtimi:

"- Avokat shteti, pranë Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.".

2. Në pikën 4 shtohen emërtimet:

"- Kryetar i zyrës vendore në Avokaturën e Shtetit.

- Jurist, pranë zyrës së përfaqësimit në gjykatat e huaja ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.870, datë 12.8.2009**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS PREZË TË QARKUT TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Prezë të qarkut të Tiranës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Prezë të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr.903, datë 19.12.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Prezë të qarkut të Tiranës".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Prezë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Komuna Prezë Lidhja nr.1

| Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit | Fusha e përdorimit të pronës | Lloji i pronës |
|---|---|---|
| 1-8 | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore. | Në pronësi |
| 9-12 | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik. | Në pronësi |
| 13-17 | Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive. | Në pronësi |
| 21-23 | Varreza publike | Në pronësi |
| 147-237 | Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike) | Në pronësi |
| 24-27 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në strehimit dhe mbrojtjes civile. | Në pronësi |
| 29 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik. | Në pronësi |
| 30-34 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive). | Në përdorim |
| 61-128 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive). | Në pronësi |

**VENDIM**
**Nr.871, datë 12.8.2009**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS QENDËR FIER, TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Qendër Fier të qarkut të Fierit, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Qendër Fier të qarkut të Fierit, miratuar me vendimin nr.702, datë 21.5.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Qendër Fier, të qarkut të Fierit".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Qendër Fier për zbatimin e këtij vendimin.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

| Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit | Fusha e përdorimit të pronës | Lloji i pronës |
|---|---|---|
| 1-132, 1008-1016 | Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji | Në përdorim |
| 133 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative. | Në pronësi |
| 134-145 | Varreza publike | Në pronësi |
| 146-168 | Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile. | Në pronësi |
| 169 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik. | Në pronësi |
| 275-283 | Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive. | Në pronësi |
| 284-288, 1000, 1001 | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik. | Në pronësi |
| 289-306 | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore. | Në pronësi |
| 316-929 | Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike) | Në pronësi |
| 935,948,950,951,959, 992-999 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive). | Në pronësi |
| 960-971 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve. | Në pronësi |

**VENDIM**
**Nr.872, datë 12.8.2009**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË ÇOROVODË, TË QARKUT TË BERATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Çorovodë të qarkut të Beratit, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Çorovodë të qarkut të Beratit, miratuar me vendimin nr.406, datë 9.6.2005 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Çorovodë, të qarkut të Beratit".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Çorovodë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

| Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit | Fusha e përdorimit të pronës | Lloji i pronës |
|---|---|---|
| 1-7 | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore. | Në përdorim |
| 8-18 | Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive. | Në pronësi |
| 22-23,25-26 | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik. | Në pronësi |
| 31,36,37,42,51 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative. | Në pronësi |
| 65-614 | Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji. | Në përdorim |
| 615 | Varreza publike | Në pronësi |
| 619-622 | Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile. | Në pronësi |
| 623-627 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik. | Në pronësi |
| 785,788 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive). | Në përdorim |
| 789 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta). | Në pronësi |

**VENDIM**
**Nr.874, datë 12.8.2009**

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E BORDIT TË MBIKËQYRJES PUBLIKE TË EKSPERTËVE KONTABËL, TË REGJISTRUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 6, e 60, pika 1, të ligjit nr.10091, datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Ngritjen e bordit të mbikëqyrjes publike (në vijim thjesht "bordi"), si strukturë përgjegjëse për mbikëqyrjen e profesionit të ekspertëve kontabël, të regjistruar, të shoqërive audituese dhe kontabilistit të miratuar, sipas qëllimit dhe mënyrave, të parashikuara në ligjin nr.10091, datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar".

I. STRUKTURA DHE PËRBËRJA

1. Bordi është organ kolegjial, i përbërë nga shtatë anëtarë, të emëruar nga Ministri i Financave, për një mandat 4-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje jo më shumë se dy herë radhazi.

2. Bordi përbëhet nga:

a) Kryetari dhe tre anëtarë, të cilët duhet të jenë persona, që nuk e ushtrojnë profesionin, sipas kuptimit të nenit 2 të ligjit nr.10091, datë 5.3.2009;

b) Tre anëtarë të tjerë, të cilët duhet të jenë persona, që mund ta ushtrojnë profesionin në praktikë, me një përvojë jo më pak se 5 vjet në auditimin ligjor të pasqyrave financiare, të shoqërive tregtare.

II. KRITERET E PËRZGJEDHJES

Anëtarët e bordit, përveç kritereve të parashikuara në ligjin nr.10091, datë 5.3.2009, duhet të përmbushin edhe kriteret e mëposhtme:

a) Anëtarët e bordit, persona, që nuk e ushtrojnë profesionin në praktikë, duhet:

i) të kenë figurë të pastër morale;

ii) të zotërojnë njohuri të mjaftueshme dhe të kenë përvojë, së paku, 5 vite, për çështjet e auditimit ligjor dhe të kontabilitetit;

iii) të mos kenë qenë anëtarë të organizatës profesionale të ekspertëve kontabël, të autorizuar, së paku, prej një periudhe prej tri vitesh para emërimit në pozicionin e anëtarit të bordit;

iv) të mos kenë pasur të drejtë vote në një shoqëri auditimi, së paku, për një periudhë prej tri vitesh përpara emërimit në pozicionin e anëtarit të bordit;

v) të mos kenë qenë anëtarë të organeve të qeverisjes dhe/ose të drejtimit të një shoqërie auditimi, së paku, prej një periudhe prej tri vitesh, para emërimit në pozicionin e anëtarit të bordit;

vi) të mos kenë lidhje të afërta, deri në shkallë të dytë, me personat në organet e zgjedhura të organizatës profesionale të ekspertëve kontabël, të autorizuar.

b) Anëtarët e bordit, persona, që e ushtrojnë profesionin në praktikë, duhet të:

i) kenë përvojë jo më pak se 5 vjet në auditimin ligjor të pasqyrave financiare, të shoqërive tregtare;

ii) shquhen për aftësi e përgjegjësi profesionale:

- të mos kenë qenë të ndëshkuar më parë me masa disiplinore, të natyrës së pezullimit të përkohshëm të ushtrimit të profesionit apo të pezullimit të kryerjes së disa llojeve të shërbimeve profesionale;

- të mos jenë anëtarë në organet e zgjedhura të organizatës profesionale të ekspertëve kontabël, të autorizuar.

III. ORGANET PROPOZUESE, PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES DHE TË SHKARKIMIT TË ANËTARËVE

1. Çdo institucion publik gëzon të drejtën e propozimit, sipas kërkesës së kandidatëve, që janë nëpunës/punonjës të institucionit propozues, për emërimin, nga Ministri i Financave, të katër anëtarëve të bordit, të cilët nuk e ushtrojnë profesionin në praktikë.

2. Çdo organizatë profesionale, që ka objekt të veprimtarisë auditimin ligjor, gëzon të drejtën e propozimit të kandidatëve, për tre anëtarë të bordit, të cilët e ushtrojnë profesionin në praktikë.

3. Kërkesa për propozim shoqërohet me dokumentacionin, që vërteton përmbushjen e kritereve, të parashikuara në ligj dhe në këtë vendim.

4. Procedurat e përzgjedhjes bazohen në konkurrimin, në bazë të dokumentacionit.

5. Ministri i Financave publikon 1 javë rresht, në faqen zyrtare të internetit të institucionit dhe në dy gazeta me tirazh më të lartë, njoftimin për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të bordit, kriteret, që duhet të përmbushen nga secili kandidat, vendin, si dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit, të kërkuar sipas këtij vendimi.

6. Afati i dorëzimit të dokumentacionit bëhet brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i afatit të fundit të shpalljes së njoftimit.

7. Ministri i Financave, brenda 30 ditëve nga afati i fundit i dorëzimit të dokumentacionit, miraton kandidaturat, të cilat plotësojnë kriteret e parashikuara në këtë vendim.

8. Lista e kandidatëve të emëruar publikohet menjëherë, tri ditë rresht në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Financave dhe në dy gazeta, me tirazh më të madh shitjeje.

9. Anëtarët, në mbledhjen e parë, përzgjedhin, ndërmjet anëtarëve, që nuk e ushtrojnë profesionin, kryetarin e bordit dhe ia përcjellin, për miratim, Ministrit të Financave, i cili, brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së propozimit, miraton kryetarin e bordit.

10. Anëtarësia në bord përfundon kur anëtari:

a) mbaron mandatin, sipas afatit të parashikuar në ligj dhe këtë vendim;

b) shkarkohet;

c) vdes;

ç) jep dorëheqjen.

11. Kryetari i bordit, 30 ditë përpara përfundimit të mandatit, për rastet e parashikuara në shkronjat “a”, “b” e “ç”, dhe 5 ditë pas përfundimit të mandatit, sipas shkronjës “c”, njofton, me shkrim, Ministrin e Financave, për përfundimin e mandatit të anëtarit/anëtarëve.

Procedura e zgjedhjes së anëtarëve të rinj realizohet sipas dispozitave dhe afateve të parashikuara në këtë kre.

12. Përjashtimisht për mandatin e parë, dy anëtarë, që nuk e ushtrojnë profesionin, ose një anëtar, që e ushtron profesionin, emërohen për një mandat 3-vjeçar.

Përzgjedhja e anëtarëve i nënshtrohet hedhjes me short. Për përzgjedhen e anëtarëve, të parashikuar në këtë pikë, ndiqet procedura e emërimit, e parashikuar në këtë kre.

13. Ministri i Financave ka të drejtë të shkarkojë një anëtar të bordit, kur:

a) ai nuk plotëson kriteret e parashikuara në këtë kre;

b) nuk merr pjesë, pa arsye, në mbledhjet e bordit për më shumë se katër herë radhazi;

c) veprimet apo mosveprimet e tij kanë dëmtuar rëndë veprimtarinë dhe emrin e bordit;

ç) nuk përmbush funksionet e parashikuara nga ligji dhe ky vendim.

14. Ministri, në rastet kur shkarkohet, dorëhiqet apo vdes një anëtar bordi, duhet të caktojë zëvendësuesin e tij brenda një afati prej 30 ditësh, duke filluar nga data e njoftimit të shkarkimit, dorëheqjes apo vdekjes, në përputhje me procedurat e përzgjedhjes, të parashikuara në këtë kre.

15. Propozimi për zëvendësuesin bëhet sipas procedurave të parashikuara në këtë kre.

IV. RREGULLAT E FUNKSIONIMIT TË BORDIT

1. Bordi e zhvillon veprimtarinë në bazë të një programi vjetor pune, i cili i paraqitet për miratim Ministrit të Financave, së bashku me raportin për veprimtarinë njëvjeçare, brenda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës dhe, pas miratimit, publikohet në faqen e internetit të organizatës profesionale të ekspertëve kontabël, të autorizuar.

2. Mbledhjet e bordit zhvillohen në vendin e përcaktuar në shkresën e thirrjes. Bordi, si rregull, zhvillon një mbledhje në muaj, por mund të mblidhet sa herë që ka çështje të rëndësishme, që duhet të shqyrtohen.

3. Organizata profesionale e ekspertëve kontabël, të autorizuar, vë në dispozicion të bordit një mjedis pune të përhershëm, ku anëtarët e tij mund të vijnë e të këshillohen me dokumentacionin përkatës. Për të garantuar komunikimin në kohë me bordin, drejtori ekzekutiv i organizatës profesionale të ekspertëve të regjistruar cakton një nga punonjësit e kësaj organizate me detyrën e sekretarit të bordit. Sekretari i bordit është i pranishëm në veprimtaritë e bordit dhe e asiston veprimtarinë në aspektin procedural, kryesisht, të mbledhjeve.

4. Thirrja e mbledhjes bëhet nga kryetari i bordit, i cili vendos datën, rendin e ditës dhe orën.

5. Kryetari është i detyruar të thërrasë mbledhjen e bordit, kur kjo kërkohet, me shkrim, nga, të paktën, 1/3 e anëtarëve, duke përcaktuar çështjet për të cilat thirret kjo mbledhje.

Lajmërimet për thirrjen e mbledhjes, në këtë rast, bëhet brenda 15 ditëve pas paraqitjes së kërkesës nga 1/3 e anëtarëve dhe, të paktën, 48 orë para orës së caktuar për mbledhje.

6. Lajmërimi për thirrjen e mbledhjes duhet të tregojë qartë dhe me hollësi çështjet, që do të diskutohen dhe dokumentacionin përkatës.

7. Mbledhja e bordit është e vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se gjysma e anëtarëve, pra jo më pak se 4 anëtarë, ku, të paktën, njëri prej tyre është ekspert kontabël, i regjistruar, që e ushtron profesionin.

8. Kur në hapjen e mbledhjes nuk janë të pranishëm shumica e anëtarëve, kryetari vendos thirrjen e saj në një ditë tjetër, të paktën, 24 orë pas së parës.

9. Në çdo rast, kryetari voton i fundit, dhe, kur ka barazi votash, vota e tij është përcaktuese.

10. Vendimet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët. Ato duhet të jenë të argumentuara dhe, në çdo rast, vendimet kundër duhet të shpjegohen.

11. Mbledhjet e bordit dokumentohen me procesverbal, i cili mbahet nga sekretari i bordit dhe nënshkruhet nga kryetari dhe sekretari i bordit, pas miratimit të të gjithë anëtarëve.

12. Bordi mund të përcaktojë rregulla të hollësishme për procedurat specifike të punës, për raste e çështje të caktuara.

13. Bordi raporton te Ministri i Financave një herë në vit, brenda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës, përmes një raporti me shkrim, ku jepen, me hollësi, problemet e profesionit të ekspertit kontabël, të regjistruar, zgjidhjet e dhëna dhe vendimet e marra.

14. Anëtarët e bordit kanë të drejtën e një shpërblimi mujor, që llogaritet, respektivisht, në masën 30 për qind, për kryetarin, dhe 20 për qind, për anëtarët e bordit, të pagës bruto të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave.

15. Shpërblimi i anëtarëve të bordit, që përballohet nga Buxheti i Shtetit, bëhet nga Ministria e Financave, pas dorëzimit në këtë institucion të procesverbalit të çdo mbledhjeje të bordit.

16. Organizata profesionale e ekspertëve kontabël, të autorizuar, nëse ka, mban regjistrime të veçanta kontabël për arkëtimet dhe pagesat e kryera, për realizimin e veprimtarisë së bordit. Gjithashtu, ajo i paraqet bordit raport për gjendjen financiare dhe për përdorimin e burimeve një herë në gjashtë muaj.

V. PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË ANKESAVE NGA BORDI

1. Bordi është autoriteti, që vendos për heqjen apo pezullimin e së drejtës për ushtrimin e veprimtarisë për shoqëritë audituese dhe ekspertët kontabël, të regjistruar, sipas rasteve të parashikuara në ligj.

2. Ekspertët kontabël, të regjistruar, kanë të drejtën e ankimimit të vendimit të marrë nga bordi. Brenda 1 muaji nga data e njoftimit të vendimit, subjekti i drejtohet, me një kërkesë, me shkrim, bordit për rishqyrtimin e vendimit të marrë. Bordi duhet të shprehet detyrimisht brenda 1 muaji nga data e depozitimit të kërkesës.

3. Ekspertët kontabël, të regjistruar, kanë të drejtën e ndjekjes, në rrugë gjyqësore, në gjykatën e juridiksionit përkatës, të vendimeve të marra nga bordi, sipas rregullave të parashikuara në nenin 328 të Kodit të Procedurës Civile.

4. Bordi merr në shqyrtim ankesat, për shkelje të pavarësisë së ekspertit kontabël ose të shoqërisë audituese, të angazhuar në auditimin ligjor të pasqyrave financiare, të listuara në bursë, të bankave ose shoqërive të sigurimeve, që kanë lidhje me rastin kur eksperti ofron edhe shërbime të tjera, që nuk janë pjesë e auditimit ligjor. Procedurat dhe afatet e shqyrtimit të ankesave bëhen, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

5. Bordi shqyrton relacionet e paraqitura nga organizata profesionale e ekspertëve kontabël, të regjistruar, për ankesat e ekspertëve kontabël, të autorizuar, dhe të shoqërive të auditimit, për rastet e shkarkimit të tyre nga shoqëria tregtare, përpara përfundimit të angazhimit të auditimit ligjor.

6. Bordi ka të drejtë të vendosë masa disiplinore ndaj ekspertëve kontabël, të regjistruar, ose shoqërive të auditimit, në varësi të shkeljes së bërë prej tyre, sipas dispozitave të parashikuara në ligjin nr.10091, datë 5.3.2009.

7. Procedurat dhe afatet e ankimit në shkallë administrative, për marrjen e masave disiplinore nga palët e interesuara, janë sipas dispozitave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative. Në çdo rast, shqyrtimi gjyqësor bëhet sipas procedurave dhe afateve të parashikuara në Kodin e Procedurave Civile, për shqyrtimin e akteve administrative.

8. Ngarkohet Ministri i Financave, që, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, të përzgjedhë dhe miratojë anëtarët e bordit, sipas propozimeve të bëra nga autoritetet e parashikuara në këtë vendimi.

9. Ngarkohet bordi i mbikëqyrjes publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.879, datë 12.8.2009**

**PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT, PARAUNIVERSITAR, GJIMNAZI "LINZ", NË QYTETIN E TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e licencës për hapjen e institucionit arsimor privat, parauniversitar, gjimnazi "Linz", në qytetin e Tiranës, i cili do ta zhvillojë mësimin edhe në gjuhën angleze.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për të ndjekur zbatimin e dispozitave, ligjore e nënligjore, për arsimimin, edukimin dhe formimin e nxënësve në këtë institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.880, datë 12.8.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE "MASTER I NIVELIT TË PARË", NË UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Universitetin Bujqësor të Tiranës, të programeve të studimit "Master i nivelit të parë", në fakultetet, si më poshtë vijon:

a) Në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit:

i) në "Teknologji e avancuar në hortikulturë", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë "Master i nivelit të parë, (MNP)", në "Teknologji e avancuar në hortikulturë";

ii) në "Mbrojtja kimike dhe fitofarmacia", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë "Master i nivelit të parë, (MNP)", në "Mbrojtja kimike dhe fitofarmacia";

iii) në "Biznes blegtoral", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë "Master i nivelit të parë (MNP)", në "Biznes blegtoral";

iv) në "Teknologjia e kultivimit të bimëve", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë "Master i nivelit të parë (MNP)", në "Teknologja e kultivimit të bimëve";

v) në "Menaxhim mjedisi", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë "Master i nivelit të parë, (MNP)", në "Menaxhim mjedisi".

b) Në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit:

i) në "Menaxhim i ndërmarrjeve", me profil "Menaxhim i ndërmarrjeve të agrobiznesit", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë "Master i nivelit të parë (MNP)", në "Menaxhim i ndërmarrjeve", me profil "Menaxhim i ndërmarrjeve të agrobiznesit";

ii) në "Ekonomi dhe agrobiznes", me profil "Financë kontabilitet", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë "Master i nivelit të parë, (MNP)", në "Ekonomi dhe agrobiznes", me profil "Financë kontabilitet";

iii) në “Ekonomi dhe politikë agrare”, me profil “Ekonomi dhe politikë agrare”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë (MNP)”, në “Ekonomi dhe politikë agrare”, me profil “Ekonomi dhe politikë agrare”.

2. Programet e studimeve “Master i nivelit të parë” realizohen me jo më pak se 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit.

3. Këto programe studimi ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Universitetit Bujqësor të Tiranës, pa efekte shtesë.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.881, datë 12.8.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, “MASTER I NIVELIT TË PARË”, NË UNIVERSITETIN E TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Shkencave Sociale, të programeve të studimit “Master i nivelit të parë”, në:

a) “Drejtim dhe administrim arsimi”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë (MNP)”, në “Drejtim dhe administrim arsimi”;

b) “Qeverisja dhe politikat publike”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë (MNP)”, në “Qeverisjen dhe politikat publike”;

c) “Këshillim psikologjik”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë (MNP)”, në “Këshillim psikologjik”;

ç) “Orientim profesional”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë (MNP)”, në “Orientim profesional”;

d) “Punë sociale”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë (MNP)”, në “Punë sociale”;

dh) “Filozofi praktike dhe humane”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë (MNP)”, në “Filozofi praktike dhe humane”;

e) “Analizë e politikës sociale”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë, “Master i nivelit të parë (MNP)”, në “Analizë e politikës sociale”.

2. Programet e studimeve “Master i nivelit të parë” realizohen me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit.

3. Këto programe studimi ta fillojnë veprimtarinë në vitin akademik 2009-2010.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Universitetit të Tiranës, pa efekte shtesë.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.882, datë 12.8.2009**

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR TË DISA SIPËRFAQEVE, PËRKATËSISHT, NË NGASTRAT E EKONOMIVE PYJORE TË QARKUT SHKODËR E LEZHË, QË DO TË PËRDOREN NGA OST, SHA-JA, PËR NDËRTIMIN E LINJËS 400 KV PODGORICË-TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "b" të pikës 1 të nenit 17 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqet, në ngastrat e ekonomisë pyjore, në zonat kadastrale nr.2624, nr.3148, nr.2363 e nr.2707, në qarkun e Shkodrës, gjithsej, 1496 (një mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë) $m^2$ , sipërfaqet në ngastrat e ekonomisë pyjore, në pasuritë me numra kadastralë K-34-76-(232-C), K-34-76-(248-A), K-34-76-(248-C), K-34-88-(8-A), K-34-88-(8-C), nr.1458, K-34-88-(24-A), K-34-88-(24-C), K-34-88-(40-A), K-34-88-(40-C), K-34-88-(56-A), K-34-88-(56-C), K-34-88-(72-A), K-34-88-(72-D), K-34-88-(88-B), nr.1624, K-34-76-(118-D), K-34-76-(134-A), nr.2660, K-34-76-(150-C), nr.2886, nr.2203, nr.1875, K-34-76-(166-D), K-34-76-(182-B), K-34-76-(183-A), K-34-76-(183-C), K-34-76-(199-A), K-34-76-(199-D), K-34-76-(215-B), K-34-76-(215-D), K-34-76-(231-B), K-34-76-(232-A), në qarkun e Lezhës, gjithsej 8212.7 (tetë mijë e dyqind e dymbëdhjetë, presje shtatë) $m^2$, të cilat do të përdoren nga OST, sh.a., për ndërtimin e linjës 400 KV Podgoricë-Tiranë, të hiqen nga fondi pyjor dhe kullosor dhe Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave, sipas tabelave 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 e 15 dhe hartave përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, pas përcaktimit në terren dhe në hartë të kufijve të rinj të fondit pyjor dhe kullosor kombëtar, që rezultojnë nga heqja e sipërfaqeve të këtyre ngastrave, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të bëjnë çregjistrimin e tyre nga kategoria "toka të zëna, kullotë" dhe "toka të zëna, pyll" dhe t'i regjistrojnë në sipërfaqe joproduktive, për vendosjen e shtyllave, pjesë të linjës së interkonjeksionit 400 KV Podgoricë-Tiranë, në përputhje me vendimin nr.1353, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor".

3. Vlera e këtyre sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të paguhet nga OST, sh.a., sipas lidhjes nr.4, që i bashkëlidhet vendimit nr.391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave".

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

6306

OST

**OPERATORI SISTEMIT TRANSMETIMIT**

## TABELA ME TE DHENAT E LINJES SE INTERKONECIONIT 400 KV TIRANE PODGORICE ZONA QARKUT SHKODER

**Qarku:SHKODER**

**Rrethi SHKODER**

**Komuna Guri i Zi, Bashkia Vau Dejes, Komuna Vig Mnele**

| Nr | Numri i shtylles | Per heqie nga fondi pyjor | Traseja e linjes | | | Rruge provizore | | | Pasuria | | | | | | Adresa e pronarit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Gjeresi | Gjatesi | Siperfaqia | Gjeresi | Gjatesi | Siperfaqia | Pronesia | Lloji I pasurise | Nr. Kadastral | Nr. pasurise | Sasia e sip prones m2 | Lloji I kultures | |
| | | m2 | m | m | m2 | m | m | m2 | | | | | | | |
| | **Mazrek** | | | | | | | | | | 2624 | | | | |
| 1 | 84 | 71 | | | | | | | shtet | Pyll | K-34-64-(180-A) | 1 | | | |
| 2 | 84-85 | | 30 | 613 | 18,375 | | | | shtet | Pyll | | | | | |
